



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.21/24
Prishtinë, më 15.11.2024, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla 506

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Shqipe Metaj-Isufi, Njazi Isaku, Pal Lekaj, anëtarë të Komisionit.

Munguan: Ferat Shala dhe Avdullah Hoti, anëtarë të Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, Salvador Elmazi, MFPT, Milaim Aliu, MFPT, Fehmi Hyseni, Kuvendi, Zoja Osmani, Kuvend, Shukrije Stublla, Kuvend, Sami Gashi, GP LVV, Egzona Tërdevci, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV, Mikel Mirakaj, Kuvend, Nexhmije Ahmeti, Kuvend, Driada Thaçi, ZKA, Ismet Krasniqi, Zyra e Presidentes.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Frina Kabashi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

Kryetari: Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Rregullore së Kuvendit, pas miratimit në shqyrtim të parë, Projektligji për buxhetin vjetor shqyrtohet nga komisioni përgjegjës- raportues dhe komisionet e tjera parlamentare. Fillimisht propozoj të shqyrtohet nen për nen pjesa tekstuale e projektligjit, kërkesat e parashtruara nga institucionet dhe agjencitë e pavarura, amendamentet e propozuara në pjesën tabelore nga deputetët dhe komisionet parlamentare.

Kryetari: Është propozuar një amendament nga Besnik Tahiri, që koeficienti për paga të rritet në 155 euro.

Hekuran Murati: Ne e kemi trajtuar këtë në ligjin për buxhet në qeveri, i kemi shtuar njësitë e koeficientit. Propozimi është joserioz. Ne jemi qeveria e vetme që brenda një mandati po i rrisim pagat tri herë brenda mandatit.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, komisioni nuk mbështet amendamentin e deputetit Besnik Tahiri.

Hekuran Murati: Të shtohet një fjali, te neni 34, paragrafi 5:

“Përfundimisht kjo ndarje buxhetore mund të përdoret nga OB për pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga gjykatat për vendimet e formës së prerë”.

Zyra ligjore –Kuvendi i Kosovës (Shukrije Stublla)

Të rishikohet neni 33, paragrafi 1 dhe 2, sepse Ligji për pagat përcakton në nenin 2, po ashtu neni 9 përcakton vlerën e koeficientin që bëhet me ligjin për buxhetin.

Neni 42, përcaktimi i ekuivalencës, kemi edhe dy gjykime të Gjykatës Kushtetuese.

Hekuran Murati: Kjo nuk qëndron për shkak të procedanit, këtë e ka bërë më herët edhe opozita kur ka qeverisur e kurrë nuk kemi dëgjuar komente nga zyra juridike.

Ne kemi pasur rastin e Ligjit për rimëkëmbje, që kishte ndryshuar 7 ligje përnjëherë, madje kishte ndryshuar edhe Ligjin për menaxhim të financave publike. Unë kam qenë kryetar komisioni në atë kohë dhe e kam ngritur këtë shqetësim, por edhe nga zyra juridike edhe e

Kuvendit, edhe nga ministrja e atëhershme Bajrami, më është thënë që s'ka problem. Ju e keni edhe Ligjin për sponsorim, që ndryshon Ligjin për të ardhurat në korporata.

Prandaj, nuk e shoh si problematike, mund të mos ketë elegancë juridike, por ka siguri juridike.

Pal Lekaj: Për mua është tmerr nëse e krahason administratën me opozitën dhe ligjet që i theksoi ka të drejtë, sepse është bazuar në vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ju kam thënë që do të ketë pengesa ligjore.

Nga kjo që u tha sot është hap shumë i mirë që ky ligj të dërgohet në Kushtetuese.

Zyra Ligjore –Kuvendi i Kosovës (Shukrije Stublla)

Te neni 85 është situata e njëjtë, si më herët, propozohet që të ndryshohet ky nen.

Edhe këtu ka pasur dy aktgjykime.

Hekuran Murati: Vlen e njëjta si për rastin e mëhershëm. Në rastin konkret, agjencia zbatuese i bie të jetë MFPT, nuk shoh ndonjë problem me interpretimin apo sigurinë juridike.

Kryetari konstatoi se me 6 vota për, miratohet pjesa tekstuale e Projektligjit për buxhet për vitin 2025.

Kryetari lexoi kërkesat e parashtruara.

Kërkesa e ARKEP-it dhe KQZ-së nuk miratohen.

Kërkesa buxhetore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari: Të miratohet kërkesa e Kuvendit, në vlerë prej 272.000,00 euro për projektet kapitale/blerje e veturave. Mjetet të merren te kodi 19607, mjetet për renovim, 60000 euro shtohen te kodi19158. Me shumicë votash, miratohet kërkesa e Kuvendit të Kosovës për investimet kapitale.

Kërkesat e Institucionit të Avokatit të Popullit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk miratohen.

Kërkesa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

Hekuran Murati: Propozimi ynë është që të shtohet edhe një pozitë, sepse për shkak të një gabimi teknik, janë buxhetuar 7 persona, jo 8.

Kryetari: Në KPMSHCK, me kod 249, numri i pozitave nga 37, bëhet 38, kategoria paga dhe shtesa rritet për 15 mijë euro.

Shuma merret nga kategoria e rezervave.

Me 6 vota kundër, nuk miratohet pjesërisht kërkesa e KPMSHCK.

Kërkesat nga Komisioni i Pavarur për Media, Zyra Kombëtare e Auditimit, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Radiotelevizioni i Kosovës, kërkesat nga Komuna e Obiliqit, kërkesat nga Komuna e Rahovecit, kërkesat nga Komuna e Gjakovës, kërkesat nga Komuna e Deçanit, nuk miratohen.

Hekuran Murati: Kemi një kërkesë nga Komuna e Shtimes, për të bërë korrigjimin e një kodi.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, mbështet riemërtimi i projektit.

Kërkesa nga Asociacioni i Komunave, për mbulimin e shpenzimeve nga kontratat kolektive

Hekuran Murati: Kërkesë shtesë nga MFPT.

Te projektet potenciale, shtohet shuma për 1 milion euro, në kuadër të MFPT-së.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohet ky amendament.

Amendamentet e deputetëve

Amendamenti nga GP Multietnik

Te subvencionet e MAPL-së, të shtohen 3 milionë euro për programin ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, si dhe te programi për infrastrukturë për komunitete, të shtohen 1 milion euro.

Hekuran Murati: Për tre milionë jemi dakorduar me komunitetet. Shuma të merret nga pensionet bazike, sepse kontigjencat nuk mund të preken.

Duda Balje: Për ne është shumë i rëndësishëm ky 1 milion euro për rrugë, sidomos për komunitetin egjiptian dhe rom, është problem për grupin që të mos kalojë kjo.

Hekuran Murati: Dakordimi ka qenë për shtëpitë, kurse rrugët nuk janë veçanërisht për komunitete, rruga mund të ndërtohet në bashkëpunim me komuna.

Kryetari: Të shtohen 3 milionë euro te MAPL, për programin ndërtimi dhe renovimi i shtëpive, mjetet të merren nga MFPT nga kodi 00100.

Amendamentet e propozuara nga deputetët.

Amendamentet nga Burim Meta, Ekrem Mustafa, Duda Balje

7 amendamente në vlerë gjithsej 7.8 milionë.

Hekuran Murati: Kërkesat nga dy amendamentet e para nuk mund të realizohen. Kërkesat nga Zyra e Presidentes mund të akomodohen, por jo në shumat e kërkuara, amendamentet nuk mund të miratohen si të tilla, pra duhet të ndryshohen.

Miratohen 900,000 euro për Zyrën e Presidencës, mjetet merren nga shpenzimet e paparashikuara/rezervat.

Miratohet buxheti 407,035.20 €mijë euro për 30 paga , shpenzimet e paparashikuara/rezervat.

Te Këshilli Konsultativ, shtohet buxheti 135 mijë euro mallra dhe shërbime për kompensimin e 27 anëtarëve/ burimi është shpenzimet e paparashikuara/rezervat.

Te Këshilli Konsultativ, te paga, shtohen 6000 euro, mjetet merren nga shpenzimet e paparashikuara/rezervat.

Shtohen edhe 400,000 mijë euro, 350 mijë për hartimin e projektit për Presidencë dhe 50 mijë euro për renovim, burimi i financimit, kodi për shpenzime të paparashikuara/investimet kapitale.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohen këto amendamente në emër të Komisionit.

Burim Meta: Këto duhet të kalojnë vetëm si amendamente tonat.

Kryetari: Për shkak të gabimeve në kode, këto mund të kalojnë vetëm si amendamente të Komisionit.

Hekuran Murati: Miratohen 900,000 euro për Zyrën e Presidencës, mjetet merren nga shpenzimet e paparashikuara/rezervat

Miratohet buxheti 407,035.20 €mijë euro për 30 paga , shpenzimet e paparashikuara/rezervat

Te Këshilli Konsultativ, shtohet buxheti 135 mijë euro mallra dhe shërbime për kompensimin e 27 anëtarëve/ burimi është shpenzimet e paparashikuara/rezervat

Te Këshilli Konsultativ, te paga, shtohen 6000 euro, mjetet merren nga shpenzimet e paparashikuara/rezervat

Shtohen edhe 400,000 mijë euro, 350 mijë për hartimin e projektit për Presidencë dhe 50 mijë euro për renovim, burimi i financimit, kodi për shpenzime të paparashikuara/investimet kapitale.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohen këto amendamente në emër të Komisionit.

Kryetari: Me shumicë votash kundër, refuzohen 7 amendamentet e deputetit Armend Zemaj.

Me shumicë votash kundër, refuzohet amendamenti i deputetëve Floretë Zejnullahu dhe Isak Shabani.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 4 amendamente të deputetit Hajdar Beqa për Këshillin Prokurorial.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 21 amendamente të deputetes Ariana Musliu-Shoshi.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 24 amendamente të deputetit Elmi Reçica.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 11 amendamente të deputetes Ganimete Musliu.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 4 amendamente të deputetit Hajdar Beqa.

Me shumicë votash kundër, refuzohet amendamenti i deputetes Ganimete Musliu&Mërgim Lushtaku.

Me shumicë votash kundër, refuzohen 5 amendamente të deputetit Mërgim Lushtaku.

Kryetari lexoi amendamentet e propozuara nga Komisioni dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe konstatoi se, pas diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, vendosi që t'i miratojë amendamentet e propozuara në pjesën tabelore si në vijim:

Amendamenti 3 - Komisioni FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Kuvendi i Kosovës”, me kod organizativ 101, në tabelën 3.2, ndryshohet si vijon:

Në nënprogramin Administrata e Kuvendit, me kod 10200, në tabelën 3.2, bëhet ndryshimi si në vijim:

Projekti me kod 19607, blerja e veturave, shuma prej 0 euro, ndryshohet në shumën 212,000 euro.

Shtohet projekti i ri me kod 19153, renovimi i ndërtesës në shumë prej 60,000 euro.

1.4 Në Organizatën Buxhetore – Shpenzimet e paparashikuara me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të investime kapitale, projekti me kod 13255, shpenzimet e paparashikueshme 2019-2023-shuma prej 1,930,000 euro, ndryshohet në shumën prej 1,658,000 euro.

Amendamenti 4 - Komisioni FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës”, me

kod organizativ 249, në tabelën 3.1, ndryshohet si vijon:

1.1 Në nënprogramin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me kod 12200 në tabelën 3.1, numri i punëtorëve nga 37 ndryshohet në 38;

1.2 Në nënprogramin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, me kod 12200 në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa, shuma prej 463,556 euro, ndryshohet në shumën 478,556 euro;

1.3 Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 7,100,000 euro, ndryshohet në shumën prej 7,085,000 euro.

Amendamenti 5 - Komisioni FunkSIONal

Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ”, me kod organizativ 201, në tabelën 3.1, ndryshohet si vijon:

1.1 Në nënprogramin huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT-së, me kod 48900, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve të subvencioneve dhe transferove, shuma prej 1,000,000 euro, ndryshohet në shumën 2,000,000 –burimi i financimit huamarrja;

1.2 Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 7,085,000 euro, ndryshohet në shumën prej 6,085,000 euro.

Amendamenti 6 - Komisioni FunkSIONal

Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ”, me kod organizativ 212, në tabelën 3.1, ndryshohet si vijon:

1.1 Në nënprogramin Administrata Qendrore, me kod 11312, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve të subvencioneve dhe transferove, shuma prej 0 euro, ndryshohet në shumën 3,000,000 euro;

1.2 Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve”, me kod 201, nënprogrami Departamenti i Pensioneve, me kod 00100 në kategorinë e shpenzimeve të subvencioneve dhe transferove, shuma prej 221,549,020 euro, ndryshohet në shumën prej 218,549,020 euro.

Amendamenti 7 - dy propozime:

Komisioni FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, me kod organizativ 102, në tabelën 3.1 dhe 3.2, ndryshohet si vijon:

Në nënprogramin Zyra e Presidentit, me kod 10500, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve, shuma prej 2,414,031 euro, ndryshohet në shumën 3,314,031 euro;

Në Organizatën Buxhetore – Shpenzimet e paparashikuara, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100 në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 6,085,000 euro, ndryshohet në shumën prej 5,185,000 euro.

Deputeti Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, me kodin 102, nënprogrami 10500, kodi funksional 0111, në kategorinë mallra dhe shërbime, shumës së aprovuar me Projektligjin e buxhetit prej **2,414,031.00 €** i shtohet shuma **900,000.00 €** dhe ndryshohet në total në shumën **3.314,031.00 €**.

Shuma 900.000,00 € merret në kodin 201, Ministria e Financave, programi mallra dhe shërbime.

Amendamenti 8- dy propozime:

Komisioni FunkSIONAL

Në nënprogramin “Zyra e Presidentit”, me kod 10500, në tabelën 3.1 numri i punëtorëve nga 79 ndryshohet në 109, në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa, shuma prej 1,092,064 euro, ndryshohet në shumën 1,499,099 euro.

Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 5,185,000 euro, ndryshohet në shumën prej 4,777,965 euro.

Deputeti Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentes”, me kodin 102, nënprogrami 10500, kodi funksional 0111, kategoria paga dhe mëditje, shumës së aprovuar me Projektligjin e buxhetit prej 1,092,064.00 € i shtohet shuma 407,035.20€ dhe ndryshohet në shumën e përgjithshme prej 1,499,099.20 €.

Propozohet që shuma të merret në kodin 201 (kontingjenca) - Ministria e Financave, programi 28900, kodi funksional 0112.

Amendamenti 9 - dy propozime:

Komisioni Funksional

Në nënprogramin Zyra e Presidentit, me kod 10500, në tabelën 3.2 në kategorinë e shpenzimeve të investimeve kapitale, shtohet projekt i ri -Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesës së Presidentit në shumë prej 350,000 euro, shtohet projekti i ri me kod 14339 -Renovimi i ndërtesës, kabinetit, shuma prej 50,000 euro.

Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nën programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 në kategorinë e shpenzimeve të investimeve kapitale , projekti me kod 13255, shpenzimet e Paparashikueshme 2019-2023-shuma prej 1,658,000 euro, ndryshohet në shumën prej 1,258,000 euro.

Deputeti Burim Meta, Duda Balje Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, me kodin 102, nënprogrami 10500, kodi funksional 0111, në kategorinë Investime kapitale, shumës së aprovuar me Projektligjin e buxhetit prej **215.000.00 €** i shtohet shuma **400,000,00 €** dhe ndryshohet në total në shumën **615.000,00 €**.

Amendamenti 10 - Dy Propozime:

Komisioni FunkSIONAL

Në nënprogramin Këshilli Konsultativ për Komunitete, me kod 24900, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve shuma prej 82,390 euro, ndryshohet në shumën 217,390 euro;

Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 4,777,965 euro, ndryshohet në shumën prej 4,642,965 euro.

Deputeti Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, në kodin 102, nënprogrami 24900, Këshilli Konsultativ për Komunitete, kodi funksional 0111, në kategorinë mallra dhe shërbime, shumës së aprovuar me Projektligjin e buxhetit prej **82,390.00 €**, i shtohet shuma **135.000,00 €** dhe ndryshohet në shumën **217,390.00 €**.

Propozohet që shuma prej 135.000,00 €, të merret në kodin 201, Ministria e Financave, programi mallra dhe shërbime.

Amendamenti 11 - dy propozime:

Komisioni Funksional

Në nënprogramin Këshilli Konsultativ për Komunitete, me kod 24900n në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve të pagave dhe shtesave, shuma prej 56,994 euro, ndryshohet në shumën 62,994 euro;

Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”, me kod 232, nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës, shuma prej 4,642,965 euro, ndryshohet në shumën prej 4,636,965euro.

Deputeti Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, në kodin 102, nënprogrami 24900, Këshilli Konsultativ për Komunitete, kodi funksional 0111, në kategorinë paga dhe mëditje, shumës së aprovuar me Projektligjin e buxhetit prej 56,994.00 €, i shtohet shuma 6,000.00 € dhe ndryshohet në shumën 62,994.00 €.

Propozohet që shuma prej 6.000,00€ të merret në kodin 201, Ministria e Financave, programi 02200, kodi funksional 1020.

Amendamenti 12 – Komisioni Funksional

Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës”, me kod 205, në nënprogramin, projektet e bashkëfinancimit me kuvende komunale, projekti me kod 19662, rivitalizimi i rrugës Shtime-Zborc, Petrovë- Llanisht, Vojnoc-Terrn, ndryshohet në emërtimin, rivitalizimi dhe rregullimi i rrugëve në Shtime dhe në fshatrat Zborc, Petrovë, Vojnoc, Godanc, Davidovc, Rashincë, Mollopolc, Lagjja e Pajtimit, Reçak.

Amendamenti 13 - Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Me qëllim të sigurimit të terapisë për pacientët e diagnostikuar me sëmundje malinje, dhe duke marrë parasysh rëndësinë dhe përgjegjësinë institucionale për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, si dhe bazuar në të drejtën dhe obligimin kushtetues dhe ligjor për sigurimin e shëndetit, propozojmë që të merren mjete nga kategoria e investimeve kapitale të ministrive si në vijim:

Ministria e Kulturës, në kodin 207–80200–810, të alokohen mjete në shumën 2.000.000,00 € për sigurimin e terapisë për pacientët në nevojë për vitin 2025.

Ministria e Mjedisit, në kodin 205–41800–0451, të alokohen mjete në shumën 2.000.000,00 € për sigurimin e terapisë për pacientët në nevojë për vitin 2025.

Ministria e Mjedisit, në kodin 207–45900–0451, të alokohen mjete në shumën 1.000.000,00 € për sigurimin e terapisë për pacientët në nevojë.

Në total, kërkohet që të sigurohen mjete në vlerën 5.000.000,00 €.

Këto mjete do të përcillen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe do t'i shtohen kategorisë së Listës së barnave esenciale.

Amendamenti 14 - Burim Meta, Duda Balje, Ekrem Mustafa, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për trajtimin e sëmundjeve të varësisë dhe në përputhje me rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si dhe ato të Avokatit të Popullit, për ndërtimin dhe funksionalizimin e plotë të institucionit për trajtimin e sëmundjeve të varësisë, si dhe duke marrë parasysh përgjegjësinë institucionale për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, propozojmë që të alokohen mjete në shumë prej 1.000.000,00 € nga kategoria e investimeve kapitale. Kjo është po ashtu në përputhje me të drejtat dhe obligimet kushtetuese dhe ligjore për sigurimin e shëndetit.

Propozohet që shuma prej 1.000.000,00 €, të merret në kodin 207–45900–0451, Ministria e Mjedisit, me qëllim të ndërtimit dhe funksionalizimit komplet të institucionit për trajtimin e sëmundjeve.

Kryetari, pas përfundimit të diskutimeve, e vendosi tekstin e projektligjit në votim, me amendamentet e propozuara dhe konstatoi se me 6 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim”, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në pajtim me nenin 80 dhe 81 të

Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 nëntor 2024, shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, dhe vendosi që për shqyrtimin e projektligjit, Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet Projektligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, me amendamentet e propozuara nga Komisioni.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 22:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit